



Prishtinë: 27.10.2021
Kodi i ZRRE-së: V_1445_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët; dhe
- Rekomandimin e DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_2247_10_21**.

në seancën e mbajtur më datë 27.10.2021 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** ankesa e konsumatorit **N.B L.L.C**, nga Theranda, si në arsyet e paraqitura në këtë vendim.
- II. **KESCO** duhet të shkarkojë konsumatorin nga korrigjimi plotësues nr. 52800DPZ-9041145 të datës 24.10.2019 në vlerë **29,784.97€**

A r s y e t i m

N.B L.L.C me datë 31.12.2019 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në Zyrën e Rregullatorit për Energji, duke kundërshtuar përgjigjen e Departamentit për Konsumator në KESCO lidhur me korrigjimin plotësues nr. 52800DPZ-9041145 të datës 24.10.2019.

Me datë 23.06.2010 punëtorët e autorizuar të KEK-ut per pranimin e grupeve matëse kanë vendosur per matje GM nr. 96220975 me gjendje të njehsorit elektrik aktiv TL=233,48 kWh dhe TU=55.71 kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv TL=65.01 kVAr dhe TU=14.86 kVAr me konstantë llogaritëse C=3000. Ekipi i KEK-ut ka evidentuar ne procesverbal qe konsumatori i ka tre njehsorë, nr.96220973, nr.96220974 dhe nr.96220975 ku ka evidentuar edhe gjendjen e shpenzimeve. Po ashtu vërtetohet se ne periudhën 05/2015 është ndërruar konstanta llogaritëse nga C=3000 ne C=1200

Provë: procesverbali-Protokoli mbi montimin-demontimin-ndërrimin e grupit matës nr. 009752 datë 23.06.2010

Punëtorët e autorizuar të KEDS-it me datë 11.09.2019 kanë inspektuar grupin matës të konsumatorit nr.96220975, ku përveç evidentimit të të dhënave teknike të pikës matëse kanë konstatuar se lidhjet janë bërë gabim ku: TMRR-1: hyrja ne primar P2 dalja në P1, qarqet sekondare 1-S1 në 1 në njehsorë, 1S2 ne 3 në njehsorë, 1S2 e togëzuar, Tensioni UI3(2 në njehsorë). TMRR e tretë: Hyrja ne primar P2 dalja ne P1, qarqet sekondare 1-S1 në 4 në njehsorë, 1S2 ne 6 në njehsorë, 1S2 e togëzuar, Tensioni UI2(5 në njehsorë), TMRR-2: hyrja ne primar P2 dalja në P1, qarqet sekondare 1-S1 në 7 në njehsorë, 1S2 ne 9 në njehsorë, 1S2 e togëzuar, Tensioni UI1(8 në njehsorë). Ekipi i KEDS-it po ashtu ka evidentuar se korrigjimet duhet te bëhen sipas të dhënave ne AMR.

Provë: Raporti mbi kontrollimin – pranimin e grupit matës nr. 0009456 i datës 11.09.2019

Me datë 11.09.2019 punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë bërë inspektimin e pikës matëse, ku kanë demontuar grupin matës nr.96220975, e gjendje të njehsorit elektrik aktiv TL=6869,413 kWh dhe



TU=2311,860 kWh dhe gjendja e njehsorisht reaktiv TL=2259,308 kVAr dhe TU=454,708 kVAr dhe kanë vendosur për matje grupin matës nr. 40240155 me gjendje të njehsorisht elektrik aktiv TL=00000,4972 kWh dhe TU=00000,0655 kWh dhe gjendja e njehsorisht reaktiv TL=00000,3724 kVAr dhe TU=00000,0075 kVAr.

Provë: Procesverbal i montimit dhe demontimit si dhe montimin të grupit matës nr. 019677 i datës 11.09.2019

Departamenti i Faturimit në KESCO me datë 24.10.2019 përmes urdhër lejimit nr. 52800DPZ-9041145 kanë ngarkuar konsumatorin korrigjimin plotësues prej **29,784.97€** duke bërë korrigjimin e faturave për periudhën një vjeçare 11.09.2018 deri në periudhën 11.09.2019 bazuar në Raporti mbi kontrollimin – pranimin e grupit matës nr. 0009456 i datës 11.09.2019, me faktor korrigjues $K=1.2498$

Provë: Korrigjimi nr. 52800DPZ-9041145 datë 24.10.2019

Me datë 03.12.2019 konsumatori ka parashtruar ankesë në KESCO duke kundërshtuar korrigjimin plotësues nr. 52800DPZ-9041145 të datës 24.10.2019 në vlerë prej 29,784.97€. Konsumatori në ankesë ka theksuar se grupi matës është pronë e KEDS-it dhe është instaluar në pronat e KEDS-it, ku mirëmbajtjen, leximin e bënë vet KEDS-i dhe se **N.B L.L.C** nuk ka qasje në objektin ku është i vendosur njehsori elektrik.

Provë: Ankesa e konsumatorit në KESCO datë 03.12.2019

Departamenti për Konsumator në KESCO me datë 20.12.2019 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar në arsyetimin se sipas procesverbalit nr. 0009456 i datës 11.09.2019 të grupit matës i **N.B L.L.C** është konstatuar se: Tensionet e tri sisteme matëse dhe rrymave kanë qenë në sisteme jo adekuate dhe atë sistemi i parë ka marrë tensionin U3 ndërsa rrymën e ka pas në kah të kundërt –I1, sistemi i dytë ka marrë tensionin U2 ndërsa rrymën e ka pas në kah të kundërt te sistemit –I3 dhe sistemi i tretë ka marrë tensionin U1 ndërsa rrymën e ka pasur në kah të kundërt –I2, dhe si rrjedhojë edhe matja e energjisë nuk ka qenë e saktë dhe se pas rregullimit të këtyre lidhjeve është bërë edhe ngarkesa shtesë për 12 muaj sipas legjislacionit në fuqi, respektivisht nenit 4.11 të Kodit të Matjes së OSSH-së si dhe nenit 28 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.

Provë: Përgjigja e Departamenti për Konsumator në KESCO me datë 20.12.2019

Me datë 31.12.2019 konsumatori ka parashtruar ankesë në ZRRE duke kundërshtuar korrigjimin plotësues nr. 52800DPZ-9041145 të datës 24.10.2019 të bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO, me arsyetimin se grupi matës është pronë e KEDS-it dhe është instaluar në pronat e KEDS-it, ku mirëmbajtjen, leximin e bënë vet KEDS-i dhe se në asnjë rast nuk ka pasur mundësi **N.B L.L.C** të bëjë ndërhyrje në kycjet e njehsorisht elektrik.

Provë: Ankesa e konsumatorit në ZRRE datë 31.12.2019,

Bordi i ZRRE-së duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEDS/KESCO, ka vërejtur se:

Me datë 23.06.2010 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për pranimin e grupeve matëse kanë vendosur për matje GM nr. 96220975 me gjendje të njehsorisht elektrik aktiv TL=233,48 kWh dhe TU=55.71 kWh dhe gjendja e njehsorisht reaktiv TL=65.01 kVAr dhe TU=14.86 kVAr me konstantë llogaritëse $C=3000$. Ekipi i KEK-ut ka evidentuar në procesverbal që konsumatori i ka tre njehsorë, nr.96220973, nr.96220974 dhe nr.96220975 ku ka evidentuar edhe gjendjen e shpenzimeve. Po ashtu vërtetohet se në periudhën 05/2015 është ndërruar konstanta llogaritëse nga $C=3000$ në $C=1200$. Sipas listave të leximit si dhe rrjedhës së energjisë elektrike vërtetohet se GM numër nr. 96220975 ka qenë i vendosur tek konsumatori nga fillimi deri në periudhën 11.09.2019 kur edhe është larguar nga matja

Provë: Procesverbal-Protokoli mbi montimin-demontimin-ndërrimin e grupit matës nr. 009752 datë 23.06.2010



Punëtorët e autorizuar të KEDS-it me datë 11.09.2019 kanë inspektuar grupin matës të konsumatorit nr.96220975, ku përveç evidentimit të të dhënave teknike të pikës matëse kanë konstatuar se lidhjet janë bërë gabim ku: TMRR-1: hyrja ne primar P2 dalja në P1, qarqet sekondare 1-S1 në 1 në njehsorë, 1S2 ne 3 në njehsorë, 1S2 e togëzuar, Tensioni UI3(2 në njehsorë). TMRR e tretë: Hyrja ne primar P2 dalja ne P1, qarqet sekondare 1-S1 në 4 në njehsorë, 1S2 ne 6 në njehsorë, 1S2 e togëzuar, Tensioni UI2(5 në njehsorë), TMRR-2: hyrja ne primar P2 dalja në P1, qarqet sekondare 1-S1 në 7 në njehsorë, 1S2 ne 9 në njehsorë, 1S2 e togëzuar, Tensioni UI1(8 në njehsorë). Ekipi i KEDS-it po ashtu ka evidentuar se korrigjimet duhet te bëhen sipas të dhënave ne AMR.

Po te njëjtën ditë ky ekip i KEDS-it ka demontuar grupin matës nr.96220975, me gjendje të njehsorit elektrik aktiv TL=6869,413 kWh dhe TU=2311,860 kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv TL=2259,308 kVAr dhe TU=454,708 kVAr dhe kanë vendosur per matje grupin matës nr. 40240155 me gjendje të njehsorit elektrik aktiv TL=00000,4972 kWh dhe TU=00000,0655 kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv TL=00000,3724 kVAr dhe TU=00000,0075 kVAr. Bordi vëren se në procesverbalin e montimin dhe demontimit të grupit matës nr. 019677 të përpiluar nga ekipi i KEDS-it vërehet se vendi ne te cilin ka qenë i vendosur Grupi Matës është TS 110/35/10- Shirok e qe është nën menagjimin e KOSTT. **Provë:** Raporti mbi kontrollimin – pranimin e grupit matës nr. 0009456 i datës 11.09.2019 dhe Procesverbali i montimin dhe demontimit të grupit matës nr. 019677 i datës 11.09.2019

Ne procesverbalet e përpiluara nga ekipet e KEDS-it nuk është evidentuar arsyeja e lidhjeve te gabuara përkatësisht problemet e paraqitura para ndërrimit apo ndryshimit te kyçjeve duke pasur parasysh se leximi i pikës matëse nga fillimi/periudha 06/2010 është bërë nga distanca me AMR dhe se te gjitha shpenzimet regjistrohen dhe monitorohen ne kohë reale. Po ashtu ZRRE vëren se grupi matës i konsumatorit është i vendosur ne pronë të KOSTT përkatësisht ne **TS 110/35/10kV, Shirokë** e që rrjedhimisht konsumatori nuk ka qasje ne grup matës që te bëjë ndërhyrjet e paraqitura nga ekipi i KEDS-it e të cilat kanë rezultuar me korrigjimin e ngarkuar. Po ashtu duke pasur parasysh që në hyrje te TS gjendet njehsori matës per energjinë hyrëse atëherë është e pamundur që nga periudha 06/2010 deri në periudhën 11.09.2019 nuk është vërejtur humbjet e mundshme te energjisë të shkaktuara nga konsumatori **N.B.L.L.C.** Po ashtu ne dokumentacionin e ofruar nga KEDS nuk është potencuar ankesa e mundshme nga konsumatori për shkak te ndërrimit te kahjeve te rrymave apo çfarëdo problemi tjetër.

Bordi ka analizuar po ashtu rrjedhën e përgjithshme te energjisë elektrike dhe konstaton se konsumatori ka luhatje per periudha te ndryshme kohore. Sipas analizave te bëra shpenzimit te energjisë elektrike me dy njehsorët elektrik nr. 96220975 dhe nr. 40240155 para dhe pas ndërhyrjeve te ekipeve te KEDS-it konstatohet se konsumatori per periudha te njëjta kohore nuk ka dallime ne shpenzimin e energjisë elektrike. Për periudhën 09/2019-08/2021 pas ndërrimit te kyçjeve nga ekipet e KEDS-it dhe vendosjes per matje te GM nr. 40240155 mesatarja mujore e shpenzimit te energjisë elektrike është 151,852 kWh(aktiv) kurse për periudhën e njëjtë para ndërhyrjes 09/2017-08/2019 me njehsorin nr. 96220975 është 149,185 kWh(aktiv) e që përkthyer në përqindje kemi ngritje të shpenzimit prej vetëm **1.78%** me njehsorin e ri. Bordi ka bere edhe krahasimet per periudha te njëjta kohore kontestuese një vjeçare me dy njehsorët elektrik nr. 96220975 dhe nr. 40240155 dhe konstaton se ka luhatje ne shpenzim. Me njehsorin elektrik nr. 96220975 per periudhën 09/2016 deri ne periudhën 09/2017 mesatarja mujore e shpenzimit te energjisë elektrike është **160,191.7 kWh(aktiv)**, per periudhën 09/2017 deri ne periudhën 09/2018 mesatarja mujore e shpenzimit te energjisë elektrike është **173,406.5 kWh(aktiv)** kurse per periudhën kontestuese (ku muaji shtator 2019 përfshin vetëm 9 ditë) per periudhën 09/2018 deri ne periudhën 09/2019 mesatarja mujore e shpenzimit te energjisë elektrike është **121,264 kWh(aktiv)** kurse me njehsorin e ri elektrik nr. 40240155 mesatarja



mujore e shpenzimit te energjisë elektrike per periudhën 09/2019 deri ne periudhën 09/2020 (ku muaji shtator 2019 përfshin vetëm 21 ditë) është **158,322 kWh(aktiv)** dhe periudhën 09/2020 deri ne periudhën 08/2021 mesatarja mujore e shpenzimit te energjisë elektrike është **146,963 kWh(aktiv)**
Provë: Rrjedha e energjisë elektrike Aktive

Bordi i ZRRE-së ka shqyrtuar korrigjimin e bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO nr. 52800DPZ-9041145 datë 24.10.2019 e i cili është bërë duke u thirrur ne nenin 4.11.1 te Kodit të Matjes së OSSH-së dhe nenit 28 paragrafit 3 të Rregullës per Kushtet e Përgjithshme te Furnizimit me Energji dhe konstaton se kjo nuk qëndron pasi që neni 4.11.1 përcakton rastet kur njehsori elektrik është teknikisht jo ne rregull ku edhe thuhet se: “Pas testimit të pajisjeve matëse dhe pasi që vërtetohet kufiri i pasaktësisë përpilohet raporti për gjendjen dhe vlerat e testuara të njehsorit. Pavarësisht a është gabimi në plus ose minus dhe tejkalon vlerën 3 herë e klasës së saktësisë (p.sh. për njehsorët e drejtpërdrejtë klasa e saktësisë është 2.0 , kufiri i lejuar do të ishte 6.0%) atëherë bëhet ri–llogaritja e energjisë dhe përmirësimi i faturimit për 12 (dymbëdhjetë) muajt e fundit përkatësisht 6 muajt e fundit për konsumatorët shtëpiak. Kur vendoset njehsori kontrollues dhe kur vërtetohet se dallimi në lexim është 1.5 herë më i lartë, atëherë veprohet siç u tha më lart kurse ne nenin 28 paragrafi 3 thuhet se: “Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese”.

Provë: Korrigjimi nr. 52800DPZ-9041145 datë 24.10.2019

Bazuar në kodin e matjes përkatësisht nenin 3.9.4 dhe 3.9.5(Testimi i njehsorëve me pajisje portabel) si dhe nenin 4.3.2 përcaktohen qartë detyrimet e OSSH-së lidhur me inspektimin dhe testimin e njehsorëve brenda periudhave te caktuara kohore si dhe përgjegjësinë mbi operimin dhe mirëmbajtjen e njehsorëve elektrik. Ne nenin 3.9.4 thuhet se: Njehsorët indirekt multifunksional të cilët kyçen përmes TMRR dhe TMT duhet që së paku 1 (një) herë në vit ose kur të merret ankesa, cilado kohë që është më e shkurtër te testohen”, kurse në nenin 3.9.5 thuhet se:” Testimi i përbashkët në prezencë të përfaqësuesit të konsumatorit kurdo që është e mundur posaçërisht TMRR, TMT, Njehsorët e kërkesës maksimale (të ashtuquajturit GM multifunksional) duhet të bëhet në bazë vjetore, ose në çdo gjashtë muaj varësisht nga rasti që paraqitet, e që ne rastin e konsumatorit **N.B L.L.C** asnjë rast nuk është respektuar kurse në nenin 4.3.2 thuhet se:” Operimi dhe mirëmbajtja e Sistemit të njehsorit përfshinë instalimin e bërë në bazë të standardeve të kërkuara, mirëmbajtjen e rregullt, kontrollimin e TMRR, TMT, dhe njehsorëve tjerë, instalimin e përçuesve, terminalet, shtrirjen e mirëfilltë të kablllove, mbrojtjen, pastrimin dhe gjendjen e lidhjeve të kutive të njehsorëve, gjendjen e plombave, leximin ditor të rregullt të njehsorëve si dhe nxjerrjen e të dhënave nga pajisja për lexim, nga Qendra Grumbulluese e të Dhënave si dhe kushtimit të vëmendjes për ndonjë prishje eventuale të sistemit të njehsorëve matës. Bazuar ne dokumentacionin e ofruar nga KEDS konstatohet se nenet 3.9.4 dhe 3.9.5 nuk janë respektuar nga KEK dhe KEDS per periudhen 06/2010 deri ne periudhën 11/2019 pasi që nuk është ofruar asnjë dokument me te cilet vërtetohet shqyrtimi periodik I grup matësit te konsumatorit kurse neni 4.3.2 vërteton përgjegjësin e OSSH-së per grup matesin nr. 96220975 e ne veçanti kur dihet fakti që njehsori është brenda TS që është pronësi e KOSTT. Po ashtu me Ligjin per Energjinë Elektrike, neni 54 paragrafi 1 thuhet se: ***Pajisjet matëse për matjen e energjisë elektrike janë pronë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, siç përcaktohet në Ligjin për Energjinë*** e që duke pasur parasysh edhe faktin që njehsori si dhe kycjet janë bërë nga ekipi I KEK-ut ne periudhën 06/2010 vërteton se konsumatori nuk ka pasur qasje ne ndërhyrjen e matjes së njehsorit elektrik.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 27.10.2021 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Gashi, anëtar

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit: N.B L.L.C
- KESCO-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së.